

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Iluzioni i produktivitetit të inteligjencës artificiale
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/iluzioni-i-produktivitetit-te-inteligjences-artificiale-i588001
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 20:10:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 20:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0cfb2c02e11dfef061a7f852f91bf3c26158bf09aa7f92705611dad4773945d5
TEKSTI	c9720db00f0e0facd54b391b714e3d6646223982e0426c90f12c95566af478af
PAMJA	e913abaed85c237d47ed43761644b2f528724a4790eee7e057a4d85419b4b282

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	64d64b0f71c0c3e63a00b49418ae1115c2a8c74247114685cb9c8575625f91f3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/64d64b0f71c0c3e63a00b49418ae1115c2a8c74247114685cb9c8575625f91f3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Plagosje me thike prane "Petro Nimit" ne "Iranelluzioni i produktivitetit te inteligjences artificiale" i rump zbulon marreveshje aksionesh me vlerë miliona dollare ne indu: fundit

Iluzioni i produktivitetit të inteligjencës artificiale

TemA

23 Shtator 2026, 22:05Bota TEMA



Nga Yanis Varoufakis, [Project Syndicate](#)

A është inteligjenca artificiale një fluskë? Gjithçka varet, na thuhet, nga fakti nëse investimet masive në këtë teknologji do ta rrisin edhe produktivitetin në mënyrë po aq masive. Ata më optimistët janë të bindur se përfitimet e ardhshme në produktivitet do të jenë kolosale, edhe nëse një korrigjim i tregut është i nevojshëm për të ulur disi temperaturën e bumit aktual. Pesimistët, nga Jim Covello i Goldman Sachs te Daron Acemoglu i MIT-së, kanë dyshimet e tyre. Por si optimistët, ashtu edhe pesimistët, janë pushtuar nga ajo që unë e quaj iluzion i produktivitetit të AI-së.

Ajo që të dyja palët nuk kuptojnë është se AI-ja do ta tronditë kapitalizmin edhe nëse e rrit produktivitetin përtej çdo imagjinate — dhe pavarësisht nëse arrin apo jo automatizimin e premtuar të proceseve të përditshme të kompanive në të gjithë ekonominë. Arsyeja pse priremi të mos e kuptojmë këtë pikë është se e shohim botën e sotme me lentet e një bote tjetër, të cilën kapitali 'cloud', sidomos tani që është fuqizuar nga AI-ja, e ka bërë të vjetruar.

Deri vonë, merrej si e mirëqenë se çdo revolucion teknologjik përfaqësonte një moment të shkatërrimit krijues. Sektorë të tërë, profesione dhe aftësi zhdukeshin nga inovacionet, të cilat sillnin sektorë, profesione dhe aftësi të reja. Automobili shkatërroi zejtarët e pajisjeve për kuaj, patkonjexhinjtë dhe kasapët e kafshëve të ngordhura, por krijoi punëtorët e industrisë së makinave, ndërtuesit e rrugëve, mekanikët dhe punonjësit e pikave të karburantit. Kalimi nga qymyri te nafta dënoi komunitete të tëra minerare, për të mos folur për sindikatat, me zhdukje. Megjithatë, në terma neto, u krijua më shumë sesa u shkatërrua. Shkatërrimi krijues u bë sinonim i rritjes ekonomike.

Përballë valës së AI-së, është e natyrshme të përqendrohemi te efekti i saj neto. A do të krijojë më shumë sesa do të shkatërrojë? Por pyetja e vërtetë është: "Më shumë çfarë?" Për t'i shpëtuar iluzionit të produktivitetit të AI-së, duhet të rimendojmë mënyrën se si e përkufizojmë produktivitetin.

Nëse me produktivitet kuptojmë detyrat e kryera për njësi pune njerëzore, nuk ka kurrfarë dyshimi se AI-ja do të jetë një sukses i jashtëzakonshëm — në fakt, tashmë është i tillë. Por nëse vazhdojmë ta masim produktivitetin me vlerën monetare të prodhuar për njësi pune, ka shumë gjasa që AI-ja të rezultojë një katastrofë e plotë.

Revolucionet e mëparshme teknologjike, nga motori me avull dhe automobili te kompjuteri personal dhe telefoni inteligjent, e zgjeruan fushën e tregjeve kapitaliste. Pavarësisht shkatërrimit të profesioneve dhe komuniteteve të tëra që lanë pas, ato sollën njëkohësisht më shumë prodhim material dhe një vlerë monetare totale më të lartë të atij prodhimi.

A do të bëjë AI-ja të njëjtën gjë? Ndoshta në Kinë, ku AI-ja kombinohet me robotikën, prodhimi material do të rritet dhe, të paktën në afat të shkurtër, edhe të

ardhurat neto. Por në Perëndim, agjentët e AI-së po vendosen kryesisht në sektorin e shërbimeve — nga amazon.com te zyrat e administratës, firmat ligjore, spitalet e shumë të tjera. Në këto fusha, kapitali ‘cloud,’ i fuqizuar nga AI-ja mund t’i tkurrë tregjet në dy mënyra të ndryshme.

Mënyra e parë, ajo për të cilën shqetësohen të gjithë, është se AI-ja do të zhdukë profesione të tëra: asistentë ligjorë, programues, përkthyes, kontabilistë, madje edhe arkitektë, matematicienë dhe mësues, duke krijuar një numër më të kufizuar vendesh pune për shkrues komandash, mbikëqyrësish, inxhienerësh dhe operatorë makinerish. Mënyra e dytë është shumë më pak e dukshme, por ndoshta edhe më shqetësuese: shndërrimi i tregjeve në çifligje ‘cloyd’ dhe i fitimeve në renta.

Siç kam argumentuar prej kohësh, Amazon mund të duket si një treg, me blerës dhe shitës të panumërt brenda mureve të tij digjitale, por i mungon tipari themelor i një tregu: decentralizimi. Në fakt, ai është më i centralizuar sesa ka qenë ndonjëherë ekonomia e planifikuar sovjetike, me një algoritëm të padepërtueshëm që vendos se cili konsumator lidhet me cilin shitës, mbi bazën e një modeli probabilistik të optimizuar për të maksimizuar mundësinë që Jeff Bezos, pronari i tij, të marrë 40% të çmimit maksimal që çdo klient është i gatshëm të paguajë.

Ndërsa AI-ja integrohet gjithnjë e më thellë në algoritmin e Bezos, ndërfaqe si Alexa do të komunikojnë me ne jo vetëm si asistente në blerje, por si miq që dinë gjithçka, shoqërues dhe madje terapeutë. Së shpejti, fitimet e shitësve kapitalistë do të përfundojnë në llogarinë e ndonjë çifligari të teknologjisë në formën e rentës ‘cloud’, të cilën ai pothuajse me siguri do ta investojë në më shumë kapital ‘cloud’ të fuqizuar nga AI-ja, që do të prodhojë edhe më shumë pushtet për të nxjerrë edhe më shumë renta të tilla.

Kështu, ndërsa Siri i Apple, Gemini i Google dhe një ushtri e tërë asistentësh autonomë zhvillojnë për zotërit e tyre teknologjikë të njëjtat aftësi që Amazon i ka dhënë Bezos, hapësira e tregut kapitalist do të vazhdojë të tkurret. AI-ja do të ketë rezultuar jashtëzakonisht produktive në kuptimin e aktiviteteve ekonomike të kryera për njësi pune njerëzore, por normat e fitimit të ndërmarrjeve kapitaliste do të bien, duke ndjekur pagat totale të shoqërisë drejt fundit. Në atë pikë, asnjë nga mjetet e shtetit liberal — as lehtësimi sasior pa kufi, as nivele politikisht të realizueshme të të ardhurave bazë universale, as një taksë mbi pasurinë që zotërit e teknologjisë do ta kishin të vështirë ta shmangnin — nuk do të mund të parandalonte një kolaps sistematik.

Pyetjes nëse AI-ja do të gjenerojë fitime masive në produktivitet i përgjigjemi lehtë: Po. AI-ja tashmë po tregon se është e aftë të rrisë në mënyrë eksponenciale sasinë e punës së kryer për çdo punëtor njerëzor. Por për sa kohë përdoret për të eliminuar punën me pagë, ndërsa thith fitimet nga tregjet reale dhe i kthen në renta të reve për zotërit e teknologjisë, vlera ekonomike e prodhuar për punëtor do të bjerë ndjeshëm.

Nëse nuk bëjmë këtë dallim, iluzioni i produktivitetit të AI-së do të vazhdojë. Dhe për sa kohë që vazhdon, nuk do të jemi në gjendje të shpresojmë për një të ardhme post-kapitaliste të bollëkut, ku ne, së bashku me ndihmësit tanë të AI-së, prodhojmë sipas aftësive dhe shpërndajmë sipas nevojave.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Trump zbulon marrëveshje aksionesh me vlerë miliona dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI - Euronews Albania](#)

21:55 Bota

Zelensky flet në OKB: Moska ka pësuar humbje poshtëruese! Vetëm një njeri dëshiron luftë në Ukrainë

20:45 Bota / 3 komente

Presidenti i Argjentinës sulmon ashpër OKB-në gjatë Asamblesë: Organizatë e padobishme që ushqen burokratë

19:15 Bota / 5 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.